

POLITIKA E PRIVATËSISË DHE (cookies)

Informacione të përgjithshme për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale

Fitimi i besimit dhe ruajtja e besimit është thelbësore për atë që ne bëjmë. Kjo është arsyeja pse ne jemi kaq të përkushtuar ndaj transparencës në marrëdhëniet tona dhe praktikën e privatësisë. Çdo informacion dhe e dhënë personale që do të na zbulohet, dhe konsiderohet si e dhënë personale, do të përpunohet vetëm nëse ka një bazë ligjore për të, pra vetëm për një qëllim të caktuar dhe sigurisht me pëlqimin tuaj në rastet kur është e nevojshme. Kjo është arsyeja pse ju ftojmë të merrni pjesë në të gjitha aktivitetet tona me besim të plotë në drejtim të mbrojtjes së të dhënave tuaja personale dhe të të dhënave të tjera. Ne nuk mbledhim informacione ose të dhëna personale nga fëmijët.

Ky dokument është një politikë privatësie dhe cookies dhe mund t'ju ndihmojë të gjeni informacionin që na nevojitet për mënyrën se si ne i trajtojmë të dhënat tuaja personale, dmth. Lexoni me kujdes dhe plotësisht këtë dokument për të mësuar më saktë se çfarë të dhënash personale mbledhim, dmth se si i mbledhim, i përdorim, i ndajmë, i ruajmë dhe i zbulojmë të dhënat tuaja personale. Politika jonë e privatësisë dhe e cookies do të ndryshohet ose përditësohet rregullisht në përputhje me aktivitetet dhe nevojat tona, për të cilat ju do të njoftoheni në kohën e duhur. Nëse keni pyetje shtesë, ju lutemi na kontaktoni direkt në: info@iarm.gov.mk

Informacione për kontakt të Kontrolluesit

Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (Gazeta Zyrtare e RMV nr. 42/2020) është në cilësinë e Kontrolluesit për të dhënat personale që i përpunon, përveç nëse në këtë dokument përcaktohet ndryshe.

Ka disa mënyra se si mund të kontaktoni Kontrolluesin, duke përfshirë kontaktin nëpërmjet të telefonit, email-it, bisedës së drejtpërdrejtë dhe postimit. Më shumë detaje mund të shihen në faqen tonë të internetit www.iarm.gov.mk

Adresa jonë e postës është:

Kej Dimitar Vlahov nr.4, objekti 2, kati 3, 1000 Shkup.

Të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave.

Zyrtari ynë për mbrojtjen e të dhënave është Dimitar Gjeorgjievski. Me të mund të kontaktoni përmes postës elektronike të publikuar në faqen e internetit, si dhe përmes adresës sonë elektronike: info@iarm.gov.mk dhe përmes adresës postare.

Si i marrim informacionet dhe të dhënat personale që i përpunojmë?

Shumica e të dhënave dhe informacioneve personale që ne i përpunojmë na ofrohen drejtpërdrejt nga ju për një nga arsyet e mëposhtme:

- Ju zgjidhni qasjen në shërbimet dhe burimet tona;
- Ju paraqisni një kërkesë për informacion;

- Ju dëshironi të merrni pjesë ose keni marrë pjesë në një event që ne kemi organizuar;
- Ju keni aplikuar për një punë tek ne;
- Ju e përfaqësoni organizatën Tuaj.

Të dhënat që mbledhim janë të kufizuara në llojet e informacionit që zakonisht mund të gjenden në kartën tuaj të biznesit dhe zakonisht, por jo ekskluzivisht, i referohen:

- Emrit dhe mbiemrit tuaj;
- Titullit / pozicionit të punës suaj;
- Emrit të kompanisë/institucionit në të cilin punoni;
- Adresës tuaj zyrtare të emailit dhe
- Numrit tuaj të telefonit.

Informacioni që marrim ndërsa Ju shfletoni faqen tonë të internetit (shfletimi i të dhënave):

Përveç llojeve të informacionit që Ju dëshironi të na jepni, ne i marrim gjithashtu informacionet teknike të mëposhtme, të cilët në kushte të caktuara mund të konsiderohen ende të dhëna personale, individualisht ose kur kombinohen me të dhënat e tjera:

- IP Adresat dhe/ose emrat e domenit të kompjuterëve që përdorni kur përdorni shërbimet tona;
- URI (Unique Resource Identifier) adresat e burimeve të kërkuara nga shfletuesi juaj i internetit;
- Koha e kërkesës;
- Metoda që përdor shfletuesi juaj i internetit për të paraqitur kërkesën deri te serveri;
- Madhësia e skedarit të marrë në përgjigje;
- Kodi numerik që tregon statusin e përgjigjes së serverit (i suksesshëm, gabim, etj.); dhe
- Parametrat që lidhen me sistemin operativ që po përdorni.

Përdorimi dhe shpërndarja e të dhënave Tuaja personale.

Çdo informacion personal që na jepni përdoret nga ne për t'ju ofruar cilësinë më të lartë të shërbimeve tona dhe informacionit të rradhitura në këtë dokument. Ne kurrë nuk do t'ia shesim informacionin tuaj personal askujt dhe as nuk do t'ia japim dikujt tjetër për përdorim të paautorizuar. Për momentin, ne nuk i ndajmë informacionet tuaja personale me palët e treta, gjë që mund të lehtësojë ofrimin e shërbimeve tona për shembull. Plani ynë për të ardhmen është të përdorim një shërbim të palës së tretë për t'ju dërguar informacione të buletinit në rast se keni rënë dakord për këtë, por kjo do të jetë një çështje e një Politike të përditësuar të Privatësisë dhe të Cookies, për të cilën do të bëhet një njoftim shtesë në kohën e duhur në faqen tuaj të internetit.

Çdo e dhënë personale që kemi marrë gjatë përdorimit tuaj të shërbimeve tona përdoret vetëm për të marrë informacion statistikor anonim në faqen tonë të internetit, si dhe për të kontrolluar funksionimin e duhur të tyre ose për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve tona. Këto të dhëna fshihen menjëherë pas përpunimit. Ne nuk do të ndajmë informacionin tuaj ose të dhënat personale

me palët e treta për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, përveç nëse kemi pëlqimin tuaj të qartë për të.

Të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave personale:

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ju keni të drejta për të cilat ne duhet t'ju informojmë. Të drejtat në dispozicion për ju varen nga qëllimi, pra arsyeja e përpunimit të të dhënave tuaja personale. Më shumë informacion për këtë temë mund të gjeni në faqen e internetit të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale www.azlp.mk, gjegjësisht t'i drejtoni një pyetje zyrtarit tonë për mbrojtjen e të dhënave personale në adresën e postuar të kontaktit të postës elektronike ose organit kompetent shtetëror gjegjësisht organit rregullativ në info@privacy.mk. Përveç kësaj, do të gjeni informacionin themelor ose bazë në lidhje me të drejtat e përmendura:

1. E drejta e qasjes

Ju keni të drejtë të kërkonti kopje të informacionit tuaj personal nga ne. Kjo e drejtë vlen gjithmonë. Ka disa përjashtime, sipas ligjit, që do të thotë se mund të mos jeni gjithmonë në gjendje të merrni të gjithë informacionin që ne përpunojmë.

2. E drejta për korrigjim

Ju keni të drejtë të na kërkonti të korrigjojmë informacionin që mendoni se është i pasaktë. Ju gjithashtu keni të drejtë të na kërkonti të plotësojmë çdo informacion që mendoni se është i paplotë. Kjo e drejtë vlen gjithmonë.

3. E drejta e fshirjes

Ju keni të drejtë të na kërkonti të fshijmë të dhënat tuaja personale në rrethana të caktuara. Kjo e drejtë zbatohet vetëm në kushte të caktuara në përputhje me ligjin.

4. E drejta për të kufizuar përpunimin

Ju keni të drejtë të na kërkonti të kufizojmë ose ndalojmë përpunimin e të dhënave tuaja personale në rrethana të caktuara në përputhje me ligjin.

5. E drejta e kundërshtimit (kërkesës për ndërprerjen e plotë të përpunimit) ndaj përpunimit.

Ju keni të drejtë të kundërshtoni përpunimin vetëm nëse përpunimi i të dhënave tuaja personale nuk është pjesë e detyrimeve tona ligjore ose është në interesin tonë legjitim.

6. E drejta për transportueshmëri të të dhënave

Kjo vlen vetëm për informacionin që Ju na e jepni. Ju keni të drejtë të kërkonti që ne të transferojmë informacionin, pra të dhënat personale që ju na jepni nga një organizatë në tjetrën (kontrollues) ose që ne t'ju japim juve. Ligji zbatohet vetëm nëse ne përpunojmë të dhënat personale bazuar në pëlqimin tuaj, ose në procesin e lidhjes së një marrëveshjeje në të cilën ju jeni njëra palë, dmth nëse përpunimi është i automatizuar ose nëse ne e përpunojmë informacionin tuaj për qëllimin e zbatimit të detyrimeve ligjore në fushën e së drejtës dhe procedurës penale.

Nuk do t'ju kërkohet të paguani asnjë tatim ose tarifë për ushtrimin e të drejtave të mësipërme, përveç rasteve kur, në varësi të kërkesës suaj, kjo lidhet me një numër veçanërisht të madh operacionesh ose aktiviteteve që lidhen me implikimet fiskale për të cilat do të informoheni paraprakisht. Në lidhje me sa më sipër, janë parashikuar përjashtime të caktuara në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për të ushtruar të drejtat tuaja, në përputhje me rregulloren e cekur, gjegjësisht duke vepruar sipas kërkesës suaj, në përputhje me ligjin, ne kemi një afat prej një muaji për t'iu përgjigjur.

7. E drejta për t'u ankuar. (E drejta për kundërshtim)

Ne punojmë me standarde të larta kur bëhet fjalë për përpunimin e të dhënave tuaja personale, por nëse keni pyetje apo probleme na kontaktoni në info@iarm.gov.mk dhe ne do t'ju përgjigjemi.

Nëse në ndonjë rast mbeteni të pakënaqur, mund të parashtroni ankesë për mënyrën se si ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në info@privacy.mk

A merrni pjesë në ndonjë ngjarje, seminar gjegjësisht punëtori, aplikoni për vlerësues/ekspert apo jeni pjesë e një aktiviteti tjetër të Institutit për Akreditim të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Qëllimi dhe baza ligjore për përpunim:

Qëllimi ynë për mbledhjen e këtij informacioni, gjegjësisht të dhënave personale është që të arrijmë të realizojmë ngjarjen dhe si t'ju ofrojmë shërbimin e duhur, cilësor dhe të pranueshëm.

Baza mbi të cilën ne mbështetemi për përpunimin e të dhënave tuaja personale në këto raste është Ligji për Akreditim dhe në rrethana të caktuara është interesi ynë legjitim si dhe pëlqimi juaj.

Ajo që na nevojitet, pra ajo që duhet të dini në këtë rast është:

Nëse dëshironi të aplikoni për një vlerësues ose të merrni pjesë në një nga ngjarjet tona, do t'ju kërkohet të jepni informacionin tuaj të kontaktit, dmth informacionin personal të kontaktit, duke përfshirë emrin e organizatës / institucionit tuaj, dhe nëse pjesëmarrja juaj konfirmohet, ju mund të kërkoni informacione të caktuara për preferencat dhe zakonet tuaja nëse bëhet fjalë për një ngjarje që zhvillohet me prani fizike. Ne gjithashtu mund të kërkojmë edhe pagesë nëse është parashikuar një tarifë për praninë, gjegjësisht pjesëmarrjen.

Pse na duhet ky informacion?

Ne e përdorim këtë informacion kryesisht për të lehtësuar mbajtjen e eventit dhe për t'ju ofruar shërbim cilësor, por në raste të caktuara e përdorim atë edhe për të përmbushur qëllimet në përputhje me ligjin. Gjithashtu, shpesh na duhen këto informacione ose të dhëna personale në mënyrë që të mund të komunikojmë me ju ose t'i përgjigjemi kërkesës suaj.

Ne nuk e ndajmë këtë informacion ose të dhënat personale me askënd dhe i fshijmë ato menjëherë pas ngjarjes, përveç nëse ka pengesa ligjore për ta bërë këtë. Ju mund t'i shihni detajet në seksionin e cookies.

Ne nuk publikojmë listat e pjesëmarrësve në ngjarje.

Sa kohë i ruajmë të dhënat tuaja personale?

Kur vizitoni faqen tonë të internetit, shfletuesi juaj automatikisht dërgon informacion në serverin e faqes sonë të internetit, www.iarm.gov.mk, i cili ruhet përkohësisht në një skedar. Në çdo rast, detajet e afatit të ruajtjes mund të gjenden në seksionin e cookies.

Rreth biskotave (Cookies)

Cookies ("biskotat") janë skedarë të vegjël që përdoren për të mbledhur informacion që ju lejon të njihni kompjuterin ose pajisjen tuaj gjatë vizitës suaj të radhës në faqen tonë të internetit, gjë që lejon akses më të shpejtë dhe më të përshtatshëm. Gjithashtu, në raste të caktuara ne shkruajmë informacione në formë të "Cookies" në kompjuterin tuaj, gjegjësisht një pajisje tjetër me të cilën lidheni me www.iarm.gov.mk për t'a përshtatur vizitën në faqen e internetit sipas nevojave dhe zakoneve tuaja.

Të gjitha informacionet që ruhen brenda "Cookies", do të përdoren vetëm për nevojat e faqes sonë të internetit në një mënyrë që privatësia ose të dhënat tuaja personale të mos cenohen.

Duke përdorur këtë faqe interneti www.iarm.gov.mk JU dakordoheni, gjegjësisht i pranoni dispozitat e listuara në Politikën e privatësisë dhe cookies të Kontrolluesit.

Pse i përdorim biskotat (Cookies)?

Ne përdorim biskotat (Cookies) në këtë faqe interneti për arsytet e mëposhtme:

Për funksionimin teknik të faqes së internetit;

Për mbledhjen e të dhënave statistikore kolektive dhe anonime;

Për të kujtuar preferencat Tuaja për mënyrën se si shfaqet faqja (preferencat për parametrat e ekranit), të tilla si kontrasti i ngjyrave ose madhësia e shkronjave;

Për të mbajtur mend / për tu kujtuar, nëse jeni apo jo dakord me përdorimin tonë të biskotave (Cookies) në këtë faqe interneti.

Kur vizitoni faqen tonë të internetit, ne mund të mbledhim disa të dhëna nga kërkimi Juaj, si IP adresa, përmbajtjen e faqes së internetit të Kontrolluesit që e keni vizituar, kur e keni vizituar atë dhe në cilën faqe interneti jeni ridrejtuar.

Kur vizitoni faqen tonë të internetit, ne përdorim një shërbim të palëve të treta - Google Analytics - për të mbledhur informacione standarde të aksesit dhe detaje të sjelljes së vizitorëve, por në një mënyrë që askush nuk do të mund të identifikohet dhe as Google nuk lejohet të zbulojë identitetet e atyre që vizituan faqen tonë të internetit.

Çfarë lloj biskotash (Cookies) përdorim?

Ne përdorim biskota (Cookies) të përhershme, të cilat e mbajnë mend kërkimin/sesionin kur përdoruesi mbyll shfletuesin, për të ruajtur statusin e përdoruesit.

Ju e bëni përzgjedhjen e cookies përmes opsionit - Cilësimet e Cookies, në ekranin fillestar të faqes së internetit të IARMV.

Informacione se si të çaktivizohen cookies për të gjitha faqet e internetit?

Menyja "Help" në shiritin e veglave të shfletuesit të kompjuterit tuaj ofron informacionin e mëposhtëm për përdoruesit:

- Si të parandaloni pranimin e biskotave të reja në shfletues;
- Si të vendosni shfletuesin që t'ju njoftojë kur merrni një biskotë të re;
- Si të çaktivizoni plotësisht biskotat.

Ka shumë informacione për biskotat në internet në rast se dëshironi të lexoni më shumë, si p.sh.: <http://www.allaboutcookies.org> (në anglisht).

Për shembull, nëse përdorni versionin 11.0 të Internet Explorer, duhet të:

- zgjidhni "Cilësimet", dhe më pas "Internet Options";
- klikoni në skedën "Privacy";
- Përdorni menynë rënëse për të zgjedhur opsionet që i preferoni.